



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:291098

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06218800

NË EMËR TË POPULLIT

PKR.nr. 111/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, , sipas Kryetarit të trupit gjykues – gjyqtari Shaqë Curri, dhe gjyqtaret Ajshe Balaj dhe Sabrije Raci anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit V.Gj. për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Peje- Departamenti për Krime të Renda PP/I.nr. 114/23, të dt. 28.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me dt. 11.09.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Lumturije Vuçetaj, te pandehurit V.Gj.dhe mbrojtësit të tij av. sipas detyrës zyrtare, me dt.16.09.2024, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.27.09.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

V.GJ., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në P., me vendbanim në Gj., rr. “.....”, p.nr., ka të kryer shkollën e mesme, identifikuar në bazë të Inj.nr....., i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i nacionalitetit rom, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

- Me datë 22.07.2023, rreth orës 11:25, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, K-Istog, në shëtitoren e pavijonit 03, pa autorizim posedon substancë narkotike te llojit “*Marihuanë*” në atë mënyrë që, i pandehuri përderisa gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale në

Institucionin korrektues si më lartë, posedon substancën narkotike të llojit *Marihuanë*, me peshë *0.1 gram*, e cila substancë nga oficerët e Qendrës Korrektuese, pas një kontrolli i gjendet të njëjtit në xhepin e djathtë të pantallonave, ku pas ekzaminimit ka rezultuar si e llojit dhe e peshës si më lartë e cila edhe është konfiskuar nga ana e policisë,

- me çka ka kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275, par. 1 pika 1.8 të KPRK-së.

Andaj konform nenit 7,21,38,39, 40, 41, 69, 70, nenit 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, nenit 269 par. 3 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPRK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë ne shumë prej 200 (dyqind) euro, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj ne afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga koha kur aktgjykimi te bëhet i plotfuqishëm dhe

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, e të cilin dënim i pandehuri do të vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku 1 (një) ditë burg, do ti llogaritet 20 (njëzet) euro, te gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 200 (dyqind) euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shume prej 50 (pesëdhjetë) euro në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të pandehurit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto prej 0.1 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr 114/23 të dt. 28.12.2023 ndaj të pandehurit V.Gj. për shkak të veprës penale posedim I paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së.

Gjykata me dt. 11.09.2024 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ne te cilin kane qenë të pranishëm prokurori i shtetit Lumturije Vuçetaj, i pandehuri V.Gj. dhe mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Meqenëse i pandehuri nuk e pranoi fajësinë Gjykata shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi me procedurën e të provuarit, fillimisht me fjalët hyrëse të palëve, pastaj me administrimin e provave personale me dëgjimin e dëshmitarit Artan Berisha, më pas janë administruar provat materiale si, Raporti Inicues Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë, me nr. rendor 166/23 i dt. 22.07.2023; Procesverbali i marrjes në pyetje nga policia për të pandehurin V.Gj. i datës 27.11.2023 pranë Qendrës Korrektuese në Dubravë K. Istog; Raporti i analizës së narkotikëve i bërë me pajisjen “NarTest” i parashtruar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë - Pejë me nr. të rastit R-2023-DKKO-HTN-PE-60 i dt. 08.12.2023; Foto-dokumentacioni si pjesë e shkresave të lëndës: 3 (tre) fotografi ku shihet substanca narkotike e llojit “*Marihuanë*” si dëshmia e evidentuar: D#1 dhe 1 (një) fotografi ku shihet substanca narkotike; Raporti pas bastisjes pozitive i dt. 22.07.2023 i përpiluar nga Qendra Korrektuese Dubravë K. Istog; Informacionet mbi të kaluarën kriminale për të pandehurin V.Gj. e nxjerrë nga data-baza policore si dhe Ekstrakti mbi dënimet penale (*i lëshuar për qëllime të procedurave penale*) i lëshuar nga KGJK - Departamenti i Evidencës Qendrore Penale me dt. 21.12.2023 dhe Procesverbali mbi marrjen e deklaratës së të pandehurit V.Gj. në procedurë paraprake pranë Prokurorisë Themelore në Pejë - DKR me dt. 27.12.2023, si dhe është dëgjuar mbrojtja e të pandehurit.

Dëshmitari A. B., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se i ka përpiluar dy raporte, njëri raport është raport inicues disiplinor me nr. 166/23, i dt. 22.07.2023, e po ashtu raporti pas bastisjes pozitive i dt. 22.07.2023 dhe qëndron plotësisht pranë të njëjtave dhe konstatimeve në të. Tutje ka deklaruar se me dt. 22.07.2023 ka qenë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i angazhuar në detyrat zyrtare, në mëngjes , eprori i tyre, mbikëqyrësi i ndan detyrat, dëshmitari ka qenë në detyrë në krahun V1, pavijonin nr. 3, detyra e tij është që lëvizjet e të dënuarve ti shoqërojë, ti përcjell gjatë gjithë ditës. Në shëtitje këtu i pandehuri Vedat ka qenë në krahun e tij ku dëshmitari ka pas përgjegjësinë me i shoqëru. Në shëtitjen e paradites, shëtitja bëhet në hapësirat e jashtme të pavijonit, mirëpo në oborr të pavijonit. Ku maksimumi i të burgosurve munden me qenë 42, mirëpo atë sa kanë qenë në shëtitje nuk e din, ka vërejt disa lëvizje të dyshimta nga i pandehuri V. Gj., afrimi tek rrjeta e pavijonit 4, ku mund të bëhet komunikimi në mes të dënuarve nga pavijoni 3 në pavijonin 4, afrimi tek dritaret e krahut V2, momentin që e ka vërejt se është duke e përcjellë i ka ndryshuar sjellja dhe pamja e fytyrës dhe nga ai moment deri në përfundim të shëtitjes, dëshmitari nuk ia ka nda shikimin, pas përfundimit të shëtitjes, e ka veçuar të pandehurin atëherë të burgosur V. Gj., dhe së bashku me mbikëqyrësin A. M., në zyrën e mbikëqyrësit e kanë bërë bastisjen me prekje, ku fillimisht nuk ka gjetur asgjë në trupin e tij, por gjatë kontrollës, të pandehurit i ka ra një letër në tokë, duke dashtë të dal nga zyra, i pandehuri ka tentu me e marr atë letër që i ra nga xhepi i djathtë, i pandehuri e ka pas një stilolaps në dorë, të cilin ne e kemi lënë aty gjatë bastisjes në tavolinë, i pandehuri e ka marr stilolapsin në tavolinë dhe është përkul me e marr letrën në tokë. Dëshmitari i ka thënë se çka është ajo, i pandehuri është ndal, nuk i ka thënë asgjë, pastaj dëshmitari nuk e ka marr letrën menjëherë deri ne momentin kur i pandehuri ka tentu me marr, pastaj dëshmitari ia ka marr letrën dhe e ka kontrollu dhe ka has në substancë narkotike të dyshuar. Me urdhër të mbikëqyrësit është

përpiluar raporti dhe ka vazhdu procedura. Tutje dëshmitari ka deklaruar se deklarimi gjatë shqyrtimit gjyqësor është deklarim në mënyrë të detajuar dhe ndryshon nga ajo që ka deklaruar në raportet e konstatuara se më parë se është bastisur i burgosuri, ku në xhepin pantollave kishte një sasi të dyshuar të lëndës narkotike e mbështjellë në letër, sasia e pa matshme. Dëshmitari ka theksuar se teshat nga lavanderia i marrin pas orës 13:00 dhe se nuk i kujtohet se ku ka punuar në atë kohe i pandehuri mirëpo ka thënë se e din se ia kanë mundësuar me udhëheqësin për shkak të problemeve shëndetësore të tij, me rekomandim të psikiatrit, qëndrimin vetëm në dhomë, dhe atë kohe nuk ka qene duke punuar ne oborr të pavijonit nr. 3 duke pastruar por ka qenë në shëtitje. Në fund dëshmitari ka thënë se një i dënuar brenda ditës, çdo lëvizje e tij që del jashtë dhe kthehet brenda është urdhëresë të bastiset, d.m.th. se mundet me u bastis mbi 10 herë në ditë. Nuk e din sa herë e ka bastis të pandehurin ditën kritike.

I pandehuri V. Gj., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se sa i kujtohet në Korrik të vitit 2023 ka qenë në vuajtje t[ë] dënimit për veprën penale grabitje, dhe se nuk ka qenë ndonjëherë i dënuar për posedim apo shitje të narkotikëve dhe se nuk është përdorues i tyre. Ditën kritike ka qenë koha e shëtitjes në orën 10:00, ka dal i kam marr sendet e punës, ka punuar tek dritarja e pavijonit nr. 3, ka fshi, edhe duqat e cigares i ka mbledh në dorë, i ka mbledh në një qoshe pastaj i ka mbledh me fshisë. Pastaj një djalë i axhës e ka thirr nga dritarja e pavijonit nr. 3 dhe i ka thënë se këtu e ki numrin e babës që është në Gjermani. I pandehuri e ka marre numrin dhe e shkru numrin në një letër, të cilën letër e ka marr nga dhoma e tij. Pastaj letrën e ka shti në xhep, e po ashtu edhe stilolapsin e ka shti në xhep. Pastaj ka punuar prapë, kur është kryer shëtitja edhe puna ka hy në zyrë, pasi e ka ftu oficeri A. B., dhe i ka thënë se ki bastisje. Oficeri A. B. i ka thënë heki nga xhepat çka ki në xhepa, i pandehuri i ka hekë krejt sendet që i kishte në xhepa, në xhepa kishte një stilolaps dhe letrën me numër të telefonit, e cila ishte e paluar. Atëherë oficeri e ka bastisë, tri herë së bashku me mbikëqyrësin. Nga xhepi ja kanë marr me numër të telefonit, edhe e kanë lënë në tavolinë, u krye bastisja dhe i kanë thënë ec. I pandehuri ju ka thënë a ka mundësi me ja jep letrën se e ka numrin e telefonit, A. i ka thënë jo dhe e ka hap letrën. I pandehurit i ka pa A. duke e hap letrën dhe doli sikur çaj apo diçka që nuk e ka njoftë, ndërsa numri i telefonit nuk e di ku ka mbet. Po ashtu ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici 27.11.2023, ajo është 100 % e saktë, ndërsa nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori me dt. 27.12.2023, sepse ju ka thënë se nuk e pranon fajësinë dhe nuk donë me fol hiq. Mirëpo pasi mbrojtësi ja ka treguar benefitet e pranimit të fajësisë tani ka fol. Në prokurori e ka fol të vërtetën, mirëpo njëherë nuk ka dasht me fol, pastaj ka fol. Letrën e ka marr në dhomë për të shkruar një numër të telefonit me laps, kjo letër nuk i është gjetur ditën kritike. E vërteta është se letrën ja ka gjujt djali i axhës nga dritarja e pavijonit nr. 3, sepse i pandehuri nuk ka ditë me shkru adresën e shtëpisë të telefonit. Letrën ja ka gjujt djali i axhës nga dritarja me numër të hyrjes, pastaj i pandehuri e ka hap letrën dhe e ka shënu numrin e telefonit. Letrën ja ka jep djali i axhës, të cilën e ka shkru ai një numër dhe një letër e ka pas i pandehuri, pastaj dy letrat i ka shti në xhep. Nuk ja dinë emrin djalit të axhës që ja ka japë letrën sepse i pandehuri nuk është rrit në Kosovë. Në prokurori ka menduar se e ka tezak, mirëpo kur ka fol me babain në telefon, babai i ka treguar se e ka djalë të axhës. I pandehuri ka shtuar se ka biseduar me babain ne telefon pas rastit, i njëjti është në Gjermani, mirëpo tani e ka kuptu që nuk e ka baba.

Prokurorja e shtetit Lumturie Vuçetaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave, dëgjimit të dëshmitarit A. B., si dhe mbrojtjes së të pandehurit u vërtetua në tërësi se i pandehuri V.Gj. është penalisht përgjegjës për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe këtë e mbështet në deklaratën e dëshmitarit, i cili i sqaroi rrethanat në të cilat është gjetur posedimi i substancës narkotike, më pastaj nga raporti i analizës së narkotikëve i cili mban dt. 08.08.2023, u vërtetua se dëshmia D#1, e cila ka qenë letra e gjetur ditën kritike nga oficeri korrektues tek i pandehuri V. Gj., ka rezultuar se ka qenë me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë 0.1 gram. Mbrojtja e të pandehurit ishte kundërthënëse në të gjitha fazat e procedurës dhe atë deklarata e dhënë në polici, në prokurori dhe mbrojtja e tij sot para gjykatës, është në shpërputhje në raport me mënyrën se si ka ardh në posedim të letrës në xhepin e pantallonave ditën kritike. Njëherë thotë se e ka pas një letër, e ka marr në tokë, të cilën e ka gjet, më pastaj, ma ka hedh tezaku i tij me një numër të telefonit të shkruar, e përfundimisht, thotë se njëherë letër e ka marr në dhomën e tij dhe njëherë ia ka hedh tani djali i axhës. E që i bie që i ka pas dy letra me një laps në xhepin e tij. Andaj këto deklarata i propozon gjykatës që mos t'ia fal besimit, meqenëse i njëjti këtë e bën vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, gjersa është po ashtu në kundërshtim edhe me shkresat tjera të lëndës. I pandehuri se a ka qenë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kjo vërtetohet nga shkresat e lëndës dhe deklarimi i të pandehurit, se është vërejt nga oficerët korrektues, po ashtu u vërtetua si nga dëshmitari, ashtu edhe nga deklarata e tij e dhënë në polici. Dhe fakti se është kontrolluar nga zyrtari korrektues në prani të mbikëqyrësit nuk u mohua as nga i pandehuri, i cili po ashtu nuk e ka mohuar se e ka pas edhe letrën në xhep me lapsin të cilin e ka marr në dhomën e tij, andaj mbi bazën e të lartcekurave i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënojë sipas ligjit, si dhe ta obligojë në paguarjen e shpenzimeve procedurale. Njëherë ta bëjë konfiskimin e substancës narkotike të propozuar në aktin akuzues dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim nga ana e gjykatës të merr parasysh rrethanat rënduese të cilat janë listuar në faqen 4 të aktit akuzues, gjegjësisht të përcaktuar në pikën V.

Mbrojtësi i të pandehurit, av., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor u administruan provat materiale dhe personale mbi të cilat vërtetohet se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale siç pretendon prokuroria në aktakuzë. Në këtë shqyrtim gjyqësor është dëgjuar dëshmitari A. B., i cili kishte shpërputhje në mes të deklaratës së dhënë sot para trupit gjykues dhe raportit të përpiluar në ditën kritike. Dëshmitari nuk ishte i sigurtë se sasinë narkotike a e ka gjetur në tokë, në xhep të pandehurit, apo e ka parë duke i rënë nga xhepi, andaj kërkon nga Gjykata që të njëjtës mos t'ia fal besimin. I mbrojturi i tij ka jetuar për shumë vite në Gjermani dhe siç vërehet ka vështirësi të bëjë dallimin në mes të kushërinjve qofshin tezakë, apo djem të axhës, sepse në gjuhën gjermane të gjithë konsiderohen si kushëri. Vet fakti se në ditën kritike tek i mbrojturi i tij është gjetur një stilolaps të cilën gjatë gjithë kohës e ka pas me vete, bashkë me letrën vërteton se i mbrojturi i tij ka pas për qëllim që ta merr një numër të telefonit të prindit të tij, të cilin e ka marr dhe letrën e ka futur në xhep. Duke pas parasysh edhe faktin se i mbrojturi i tij ka qenë në një dhomë më të privilegjuar se dhomat tjera, dyshon se atë sasi të narkotikëve të ja ketë futur dikush tjetër në xhep, me qëllim që i njëjti të dërgohet në izolim, për ta humbur atë dhomë dhe aty të vijë dikush tjetër. Këtë e bazon edhe në faktin, sepse sasia prej 0.1 gr, përveç problemit që mund ti shkaktojë dikujt, është e pamundur të përdoret në ndonjë

mënyrë, andaj duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat gjykatës i propozon që ta refuzojë aktakuzën e prokurorisë dhe të mbrojturin e tij ta shpall të pafajshëm.

I pandehuri V. Gj., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit së tij.

Gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata këtë gjendje faktike vërtetoi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata gjeti se sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr 114/23 të dt. 28.12.2023 i pandehuri V.Gj. akuzohet, për shkak të veprës penale posedim I paautorizuar I narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së.

Në neni 269 par.1 të KPRK-së, është paraparë që “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me...”, ndërsa neni 275 par. 1 të KPRK-së thotë se “Nëse vepra penale nga nenet 267, 268, 269, 270 ose 272 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me” e që në rastin konkret i pandehuri ka poseduar narkotikun brenda institucionit të burgut e që lidhet me pikën 1.8 të KPRK-së ku thuhet se: “vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues”, pra është përshkruar forma e kryerjes se kësaj vepre penale dhe një nga elementet e kësaj vepre është edhe kryerja e veprës penale brenda institucionit të burgut.

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e vërtetoi nga deklaratat e dëshmitarit A. B. i cili në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 11.09.2024 në mënyrë të detajuar ka përshkruar veprimet e të pandehurit V. dhe atë se si fillimisht, deri sa i pandehuri ka qenë në shëtitje dëshmitari A., ka vërejtur tek i pandehuri, disa lëvizje të dyshimta, afrimi i tij tek rrjeta e pavijonit 4, ku mund të bëhet komunikimi në mes të dënuarve nga pavijoni 3 në pavijonin 4, afrimi tek dritaret e krahut V2, dhe në momentin që e ka vërejt se është duke e përcjellë nga dëshmitari A. i ka ndryshuar sjellja dhe pamja e fytyrës dhe në përfundim të shëtitjes është bastisë nga ana e dëshmitarit nga xhepi i të pandehurit i ka rënë një copë letër në të cilën është gjendur narkotiku i llojit marihuanë.

Në fotot që u administruan si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, shifet narkotiku, i cili narkotik ditën kritike është gjetur tek i pandehuri, ku gjatë bastisjes i kishte rënë nga xhepi i pantallonave, e i cili narkotik nga Raporti i analizës së narkotikëve i bërë me pajisjen “NarTest” i parashtruar nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë - Pejë me nr. të rastit R-2023-DKKO-HTN-PE-60 i dt. 08.12.2023, ka rezultuar te jetë i llojit marihuanë.

Po ashtu nga Raporti Iniciues Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë, me nr. rendor 166/23 i dt. 22.07.2023, është vërtetuar fakti se ditën kritike tek i pandehuri është dyshuar se ka

diçka dhe pasi që ju ka ber bastisja në xhep, ka rezultuar se e ka pas një letër në të cilën ka qenë e mbështjellë diçka e dyshuar si substancë narkotike, e i cili pas bërjes së testit Nar testit ka rezultuar te jetë i llojit marihuanë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtjes së të pandehurit, se deklarimi i dëshmitarit nuk është e njëjte me atë të dhënë në raportin e policisë, mirëpo Gjykata gjeti se deklarimet e dëshmitarit në esencë janë të njëjta vetëm se gjatë shqyrtimit gjyqësor është deklaruar në mënyrë me të detajuar.

Gjykata e ka vlerësuar mbrojtjen e të pandehurit V.Gj. i cili mohon veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, duke pretenduar se për letrën nuk ka pasur dijeni se kush ia ka vënë në xhep duke u deklaruar se nje letër e ka marr në dhomën e tij me një stilolaps për të shënuar numrin kontaktues te babait të tij në Gjermani, dhe se djali i agjes e ka thirr nga dritarja e pavijonit nr. 3 dhe i ka thënë se që ku e ki numrin e babës tond në Gjermani, se letrën ia ka gjujt djali i axhës nga dritarja me numër të hyrjes, e ka hap letrën dhe e ka shënu numrin e telefonit . Këto pretendime të të pandehurit nuk qëndrojnë ngase i pandehuri edhe në mbrojtjen e tij të dhënë në të gjitha fazat e procedurës dhe atë deklarata e dhënë në polici, në prokurori dhe mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë qenë kundërthënëse. Mbrojtja e të pandehurit është e kundërshtim me vet deklarimin e te pandehurit në raport me mënyrën se si ka ardh në posedim të letrës në xhepin e pantallonave ditën kritike. Njëherë thotë se e ka pas një letër, e ka marr në tokë, të cilën e ka gjet, më pastaj, ma ka hedh tezaku i tij me një numër të telefonit të shkruar, e përfundimisht, thotë se njëren letër e ka marr në dhomën e tij dhe njëren ia ka hedh tani djali i axhës. E që i bie që i ka pas dy letra me një laps në xhepin e tij e të cilin fakt nuk e ka mohuar se e ka pas edhe letrën në xhep me lapsin të cilin e ka marr në dhomën e tij,

I pandehuri në deklaratën e dhënë ne Polici me dt. 27.11.2023, ka deklaruar se letrën e ka gjetë ne tokë edhe e ka mare e ka shti në xhep duke menduar se është numër telefoni.

Në deklaratën e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë - DKR me dt. 27.12.2023. ka deklaruar se të njëjtën e ka gjetur në tokë, dhe e ka marrë këtë letër në tokë në shëtitore, pasi që aty punon si pastrues për ti mbledhur mbeturinat, pasi që paraprakisht e ka kërkuar nga një i dënuar tjetër të cilin e ka tezak që më ja jep numrin e telefonit të familjareve që i ka jashtë dhe duke menduar se është numri i telefonit e ka futur ne xhep dhe aty e kanë vërejtur gardianet.

Ne deklaratën e dhëne në shqyrtimin gjyqësor, me dt.11.09.2024, ka deklaruar se, një djalë i axhës e ka thirr nga dritarja e pavijonit nr. 3 dhe i ka thënë se këtu e ki numrin e babës që është në Gjermani. I pandehuri e ka marre numrin dhe e shkru numrin në një letër, të cilën letër e ka marr nga dhoma e tij. Pastaj letrën e ka shti në xhep, e po ashtu edhe stilolapsin e shti në xhep. Ka deklaruar se djali i axhës i cili ja ka dhënë letrën me numër të telefonit nuk ja din emrin, mirëpo babai i tij i ka treguar se e ka djalë të axhës, i pandehuri ka deklaruar se tani e ka kuptuar se ai nuk është babai i tij.

Gjykata gjeti se deklaratimet e të pandehurit kanë qenë kundërthënës ne mes tyre, si për nga fakti se si ka ardhë deri ne posedim të asaj letre, ashtu edhe për faktin se një herë, ka deklaruar se ja ka dhënë djali i tezes, pastaj djali i axhës, mirëpo nuk ja din emrin djalit të axhës.

Andaj deklaratave të pandehurit Gjykata nuk ju fali besimin, meqenëse i njëjti këtë e bën vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, gjersa është po ashtu në kundërshtim edhe me shkresat tjera të lëndës dhe gjate gjithë deklaratimit të tij ishte kundërthënës.

Faktin se i pandehuri qenë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kjo vërtetohet nga shkresat e lëndës dhe deklarimi i të pandehurit.

Nga të cekurat me lartë Gjykata vërtetoi faktin se i pandehuri V.Gj. është përgjegjës për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kjo për faktin se nga dëgjimi i dëshmitarit dhe administrimit të provave, si dhe vet deklarimi i të pandehurit u vërtetua se vepra penale është bërë me dashje ka poseduar lëndën narkotike brenda në burg.

Pra nga të gjeturat me lartë Gjykata vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurit V.Gj. qëndrojnë të gjitha elementët e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 e lidhur me nenin 275 par. 1 pika 1.8 të KPRK-së, sepse i njëjti përderisa gjendet në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale në Institucionin korrektues si më lartë i cili ditën kritike në Qendrën Korrektuese në Dubravë, K-Istog, në shëtitoren e pavijonit 03, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike te llojit “*Marihuanë*” në atë mënyrë që, me peshë 0.1 gram.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana lehtësuese ndaj të pandehurit, Gjykata mori sasinë jo të madhe të narkotikut të zënë, e ku pesha e përgjithshme ishte prej 0.1 gramë. Ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të pandehurit, Gjykata mori faktin se i pandehuri ka qenë i dënuar edhe me pare dhe atë sipas Aktgjykimit P.nr. 756/2018 të dt. 17.10.2019 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, sipas Aktgjykimit P.nr. 24/2019 të dt. 19.12.2019 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, sipas Aktgjykimit PKR.nr. 68/2019 të dt. 01.07.2020 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale grabitje nga neni 329 të KPRK-së dhe për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 të KPRK-së dhe veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë dhe sipas Aktgjykimit P.nr. 376/2019 të dt. 22.10.2020 nga Gjykata Themelore e Gjakovës i dënuar për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 të KPRK-së i dënuar me dënim me burgim dhe me dënim me gjobë, e për të cilat vepra edhe ka qenë dhe është në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se

vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar shpenzimet e procedurës penale, për paushallin gjyqësor në shumën prej 200 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedurë e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 269 par.3 të KPPK-së, Gjykata ka konfiskuar, substancën narkotike të llojit marihuanë me peshë neto prej 0.1 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 111/23 më datë.27.09.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta**

**Kryetari i Trupit Gjykses
Shaqë Curri**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.